



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primijsno/Prodato Received/Delivered	26.10	3	viti god year
Organ /Bjësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	In Prot Br Prot Prot No	Shifra e Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKENJSHACK	6706/2023		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1127/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1127/2023, të datës 29.08.2023, të parashtruar nga ankuesi _____ nga Peja, kundër organit të punësimit: Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike „masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.6; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 26.10.2023, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

- I. Shfuqizohet** Vendimi me numër KD.nr.050/23 i datës 03.08.2023, i Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues dhe **çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje** te organi i njëjtë i cili e ka nxjerrë aktin e kontestuar administrativ.
- II. Obligohet** Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rishqyrtimin e çështjes siç përcaktohen në pikën I të dispozitivit, duke vepruar në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil _____ (tutje referuar ankuesi), më datë 29.08.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1127/2023, kundër Vendimit me numër KD.nr.050/23 të datës 03.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, për shkak të: zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm vetëm Këshilli)

në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.09.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 29.09.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 6463/2023, të datës 09.10.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1127/2023, të datës 29.08.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 29.08.2023 me numër protokollit 1127/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KD.nr.050/23 të datës 03.08.2023 të Komisionit Disiplinor; Thirrje e datës 11.07.2023 përmes telefonit mobil; Kërkesën për pushim pa pagesë të datës 19.07.2023 nga ankuesi; Raportin mjekësor të datës 22.05.2023 për F.L; Raportin specialistik të datës 25.02.2023 për F.L; Raportin specialistik të datës 27.05.2023 për F.L; Raportin mjekësor të datës 18.07.2023 për F.L; Raportin mjekësor të datës 18.07.2023 për S.L; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.09.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 29.09.2023 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Komunikimin elektronik të datës 28.09.2023 nëpërmjet e-mailit zyrtar ndërmjet zyrtarëve për burime njerëzore në SHKK; Akt emërimit e ankuesit me numër AE.Nr.040/2022 të datës 24.06.2022; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit të datës 17.07.2023; Procesverbalet e intervistës të datës 01.08.2023 nga anëtarët e komisionit disiplinor për ankuesin; Dëshmi mbi evidencën e hyrje-daljeve për muajin korrik 2023; Komunikimet elektronike të datës 17.07.2023 ndërmjet zyrtarëve gjegjësisht të SHKK-së lidhur me rastin e ankuesit; Ftesën e datës 27.07.2023 për intervistë ndaj ankuesit; Ftesën e datës 27.07.2023 për intervistë ndaj A.U; Komunikimet elektronike të datës 21.07.2023, 17.07.2023 ndërmjet zyrtarëve gjegjësisht të SHKK-së; Kërkesën e ankuesit të datës 24.05.2023 lidhur me transferin; Komunikimet elektronike të datës 31.07.2023, 27.07.2023 ndërmjet zyrtarëve gjegjësisht të SHKK-së lidhur me rastin e ankuesit si dhe Flet kthesën e datës 08.08.2023 për ankuesin nga SHKK-ja si dhe Vendimin për vazhdim të afatit të ankesës së ankuesit në Këshill me numër protokollit 6463/2023 të datës 09.10.2023; Procesverbalin e seancës dëgjimore në Këshill të datës 20.10.2023 lidhur me lëndën e ankuesit; Komunikimet elektronike të datës 16.10.2023, 23.10.2023 ndërmjet zyrtarëve gjegjësisht në Shërbimin Korrektues të Kosovës lidhur me rastin e ankuesit si dhe dëshminë për thirrjet nga fletorja e regjistrit sipas datave 09.07.2023, 10.07.2023, 11.07.2023, 12.07.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka vlerësuar që lënda e ankuesit sipas ankesës me numër 1127/2023 të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi që ka nxjerr aktin administrativ të kontestuar, *sepse:*

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe se i njëjti sipas Akt emërimit me numër AE.Nr.040/2022 të datës 24.06.2022 është emëruar dhe ushtron pozitën e punës si *Zyrtar korrektues* në Qendrën Korrektuese në Dubravë.

Me tej nga provat materiale të kësaj çështje rezulton se Udhëheqësi i Zyrës së Orareve me datë 17.07.2023, përmes shkresës më numër të protokollit 121/202, ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit me arsyetimin se ankuesi nga data 07.07.2023 ka munguar në punë dhe nuk ka lajmëruar për mungesën në punë, duke pretenduar se ankuesi me këto veprime ka bërë shkelje disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues, me Vendimin më numër me numër KD.Nr.050/2023 të datës 03.08.2023 ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06-L - 114 për Zyrtarët Publikë , duke i shqiptuar masën disiplinore “*Largimi nga shërbimi civil*”.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se ndaj tij është marrë masa më e rëndë disiplinore ajo e largimit nga shërbimi civil, marrë parasysh faktin se pak para inicimit të procedurës disiplinore e ka pasur përmbylljen e vlerësimit të periudhës provuese një vjeçare dhe se nuk është njoftuar për ndonjë vlerësim negativ. Po ashtu i njëjti deklaron se Komisioni Disiplinor me rastin e vendimmarrjes ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, ngase mungesat në punë kanë ardhur si rezultat i sëmundjes së nënës së tij e cila vuan nga një sëmundje e rëndë dhe është duke marrë trajtim dhe mjekim të vazhdueshëm, e cila ka raste kur është e pa aftë për kryerjen e aktiviteteve personale dhe e ka të nevojshëm shoqërimin dhe mbikëqyrjen, thekson se organin e punësimit e ka njoftuar edhe përmes telefonit lidhur me mungesat në punë, nga ana e Këshillit kërkon që ti aprovohet ankesa dhe të shfuqizohet vendimi i Komisionit Disiplinor me numër KD.Nr.050/23 të datës 03.08.2023.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Kolegji i Këshillit me datë 20.10.2023, ka mbajtur seancë dëgjimore ku në cilësi të palëve në procedurë janë ftuar: ankuesi në pozitën si Zyrtar Korrektues në Qendrën Korrektuese në Dubravë si dhe Zëvendësuesin e Drejtorit në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë në cilësinë e Kryesuesit të Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ankuesi në seancën dëgjimore ka deklaruar se: *“Desha të theksoj se mendoj që ka qenë pak e padrejtë, thekson se ka munguar vetëm pesë ditë prej datës 07.07.2023 deri më datën 19.07.2023, kur kam dal nga puna jam paraqit e kam pas edhe një kërkesë të protokolluar me vete ku kam kërkuar edhe pushim pa pagesë, mirëpo mendoj se është e pa drejtë kur më kanë thënë se duhet me prit për arsye se emri juaj është procedura tek Komisioni Disiplinor dhe qysh të vendoset tek komisioni ashtu do të jetë, që len me kuptua se vijimi në punë nuk duhet të bëhet deri të përfundon punën komisioni. Më kanë njoftuar më vonë që me datën 01.08.2023 kam me u paraqit tek komisioni disiplinor, mendoj që është bërë shkelja këtu që më kanë ftu me dorëzu uniformën dhe pajisjet pa u bo i plotfuqishëm vendimi. Në komision kur kam qenë, nuk ka qenë një sjellje e mirë prej njërit nga anëtarët pjesëmarrës, ai që nga fillimi ka filluar me gjyku pa i shikuar dokumentet fare si psh. jo s'ja paska vlej të ligjërata në akademi, s'paska qenë i vëmendshëm etj. Unë e kam cek se i kam dorëzuar edhe dy kërkesa për transfer dhe më kanë thënë që asnjërën se ke dërguar. Në vendimin e tyre thuhet tek kush e ke përcjelle kërkesën për transferim, ndërsa ankuesi deklaron se në vendim është thënë që zyrtari tek i cili janë dorëzuar dokumentet ka qenë i panjohur për ankuesin, ndërsa i njëjti thekson se e ka përshkruar personin zyrtar tek i cili e ka dërguar kërkesën. Në seancë kam deklaruar se ngjashëm kanë vepruar edhe me një zyrtar tjetër i cili ka qenë në ligjërata bashke me mu e ku të njëjtit i janë pranuar kërkesat për transfer, ku emri i të njëjtit është . Konstatimi në vendim se në pyetjen e komisionit disiplinor se a e keni ditur se keni aplikuar në Qendrën Korrektuese në Dubravë, ka qenë i pa saktë*

sepse unë kam deklaruar se me kohën e aplikimit e kam pasur vëllaun gjallë dhe pas vdekjes së vëllaut kah fundi i muajit prill, ka ndryshu nevoja që për ndryshim të vendit të punës nga Dubrava për në Pejë, pasi që unë jetoj vetëm me prindërit e mi. Kur kam deklaruar se i kam dorëzuar kërkesat për pushim mjekësor, të njëjtit me kanë thënë se ti kishim refuzuar menjëherë edhe pse pa i shikuar fare, vlerësoj se vendimi i kontestuar është i pa drejtë dhe i pa bazuar”.

Ndërsa, Kryesuesi i Komisionit Disiplinor në seancën dëgjimore ka deklaruar se: “Inicimi i procedurës ka ardhur me datë 17.07.2022, ndërsa në shkresat pasuese thuhet që zyrtari korrektues , ka pasur mungesë në detyrë të punës nga data 07.07.2023, kjo është situata çfarë është paraqitur në Komisionin Disiplinor të SHKK-së. Na e kemi ftuar iniciuesin dhe palën sipas procedurës, pasi që kemi intervistuar iniciuesin z. _____ i cili është në pozitën e Udhëheqësit të zyrës së orareve në Qendrën Korrektuese në Dubravë, i njëjti ka deklaruar se edhe pse disa herë është munduar me ja mbulu mungesat pasi që ka pasur mungesa të pa arsyeshme edhe më herët gjatë periudhës gjashtë mujore të parë, pasi që ka filluar punën me datë 30.01.2023 në Qendrën Korrektuese në Dubravë dhe dihet që ligjërisht gjatë periudhës gjashtë mujore nuk i ka takuar as pushimi vjetor, i njëjti është munduar edhe t’ia përshtat ndërrimin që më pas sa më të lehtë udhëtimin, por prapë se prapë ka pasur mungesa. Në shkresat e lëndës të cilat i janë paraqit komisionit mungesa të zyrtarit që kanë qenë pa arsye kanë qenë nga data 07.07.2023 deri me datën 19.07.2023. Kur i njëjti është paraqit tek zyrtari i personelit të Qendrës Korrektuese në Dubravë dhe ka paraqitur një kërkesë për pushim pa pagesë. Sa i përket çështjeve të transferit procedura është që zyrtari korrektues duhet ti drejtohet institucionit korrektues, zyrës së burimeve njerëzore të cilët e përcjellin tek drejtori i institucionit në Qendrën Korrektuese në Dubravë, atëherë drejtori duhet të jep rekomandim pozitiv apo negativ dhe ta paraqes tek drejtori i përgjithshëm i SHKK-së, këtë po e them vetëm si shpjegim të procedurës pasi që në asnjë moment ne nuk kemi pranuar dokument ku vërtetohet se kërkesa ka shkruar në një vend të caktuar po flas si komision disiplinor”.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit i u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Nenit 45, me të cilin është përcaktuar se: “Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”.

Nenit 46, me të cilin është përcaktuar se: “... Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11.



përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.

Nenit 47 paragrafit 1, me të cilin në mënyrë taksative janë përcaktuar masat disiplinore: “*Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil*”.

Nenit 48, me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore: “*3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor*”.

Referuar kuadrit ligjor si më lartë, Kolegji i Këshillit ka analizuar aktin e kundërshtuar me ankesë në ndërlidhje me provat materiale të kësaj çështje juridiko-administrative dhe si rrjedhojë vlerëson se Komisioni Disiplinor me rastin e vendosjes lidhur me përgjegjësinë disiplinore të ankuesit nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen e fakteve, sepse, Komisioni Disiplinor nuk ka saktësuar saktë periudhën kohore të mungesës në punë të ankuesit gjegjësisht ditët e mungesës në punë. Në këtë kontest, Kolegji sipas analizimit të listave të orarit të planifikuar ka gjetur se ankuesi nga data 07 korrik 2023 deri me datë 17.07.2023, kur është bërë inicimi i procedurës disiplinore, ka munguar në punë për datën: 07/08 korrik 2023 (orar i ndërrimit); 10 korrik 2023, 11/12 korrik 2023 (orar i ndërrimit) dhe 15/16 korrik 2023 (orar i ndërrimit), kurse për datën 17.07.2023 me asnjë provë të organit të punësimit nuk dëshmohet se ankuesi ka qenë i planifikuar të dal në punë, pra ekzistojnë vetëm katër (4) ditë mungesë në punë deri me datën e inicimit të procedurës disiplinore. Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi ka munguar në punë edhe më datën 18 korrik 2023, ndërsa i njëjti me datë 19.07.2023 lajmërohet në punë duke parashtruar edhe kërkesë për transferim nga Qendra në Dubravë në QP në Pejë e cila kërkesë sipas ankuesit nuk është pranuar nga zyra e personelit me arsyetimin se është iniciuar procedurë disiplinore ndaj tij.

Përkitazi me periudhën tjetër të mungesës në punë të ankuesit gjegjësisht periudhën nga data 18.07.2023 e tutje deri në marrjen e vendimit të Komisionit Disiplinor i kundërshtuar me ankesë, Kolegji nga provat materiale të çështjes nuk ka gjetur dëshmi lidhur me udhëzimet e ankuesit për ardhjen apo mos ardhjen e tij në punë pas inicimit të procedurës disiplinore, dhe po ashtu edhe Komisioni Disiplinor nuk ka argumentuar këtë periudhë të mungesës së ankuesit në punë.

Në kuptim të mos arsyetimit të mungesës në punë të ankuesit, Kolegji nga shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi me datë 11.07.2023 në ora 21:56, ka telefonuar dhomën e kontrollit tek organi i punësimit ku sipas librit të regjistrimit është shënuar “*ora 22:00, Oficeri veton Lajçi njofton se ka rast familjar*”, fakt ky të cilin Komisioni Disiplinor nuk e kishte marrë parasysh me rastin e vendosjes lidhur me çështjen disiplinore të ankuesit.

Përkitazi me faktin e deklaruar nga Kryesuesi i Komisionit Disiplinor në seancën dëgjimore së ankuesi disa herë ka pas mungesa të paarsyeshme në punë edhe gjatë periudhës provuese gjatë të cilës ankuesi nuk ka të drejtë në pushim, Kolegji bazuar në analizimin e aktit të goditur me ankesë nuk ka gjetur së një fakt i tillë ishte pretenduar dhe vërtetuar në vendimin në fjalë, dhe njëkohësisht nga organi i

punësimin nuk është prezantuar ndonjë dëshmi që vërteton se ankuesi kishte mungesa të pa arsyetuara të mungesës në punë gjatë periudhës provuese.

Andaj, bazuar në rrethanat e lartë cekura, Kolegji vlerëson se Vendimi KD.nr.050/23 i datës 03.08.2023, i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmban të meta të cilat pamundësojnë vendosjen meritorie lidhur me këtë çështje juridiko administrative, kështu që Kolegji vendosi që të anulohet akti i kontestuar më ankesë dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me detyrimin që i njëjti në ri procedurë të marrë për bazë rrethanat dhe faktet si më lartë dhe të veproj në pajtim me nenin 50 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: 2. *Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer si dhe të nxjerr vendim mbi bazën e fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.*


Përmbledhur si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1127/2023

Ardita Percuku-Shyti


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi,


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.